



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETEROR I ZGJEDHJEVE

Data: 18 Mars 2022

Nr: 138

VENDIM

**PËR SHPALLJEN E REZULTATIT TË SHORTIT PËR EMËRIMIN E EKSPERTËVE
KONTABËL TË LICENSUAR (AUDITUES LIGJOR), TË CILËT DO TË KRYEJNË AUDITIMIN
E FONDEVE TË PËRFITUARA DHE TË SHPENZUARA NGA SUBJEKTET ZGJEDHORE, SI
DHE KANDIDATËT PËR KRYETAR BASHKIE, PËR FUSHATËN ZGJEDHORE PËR
ZGJEDHJET E PJESSHME VENDORE, TË DATËS 6 MARS 2022**

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “ë”, e 2, 92/6 dhe 92/7, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe vendimit nr. 15, datë 26.2.2022, “Për disa shtesa në udhëzimin nr. 14, datë 9.6.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për caktimin e kriterëve, procedurat për përzgjedhjen dhe emërimin e ekspertëve kontabël të licensuar (audituesve ligjorë) dhe kushtet kontraktuale për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike gjatë vitit kalendarik dhe subjektet zgjedhore dhe kandidatët e tyre në fushatën zgjedhore”,

VËREJ:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në vlerësim të rëndësisë, transparencës së procesit, si dhe në zbatim të vendimit nr. 15, datë 26.2.2022, “Për disa shtesa në udhëzimin nr. 14, datë 9.6.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për caktimin e kriterëve, procedurat për përzgjedhjen dhe emërimin e ekspertëve kontabël të licensuar (audituesve ligjorë) dhe kushtet kontraktuale për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike gjatë vitit kalendarik dhe subjektet zgjedhore dhe kandidatët e tyre në fushatën zgjedhore”, më datë 03.03.2022 deri më datë 11.03.2022, shpalli njoftim publik në faqen zyrtare, për të gjithë personat e interesuar që mbajnë titullin ekspertë kontabël të licensuar (auditues ligjor), për të marrë pjesë në procesin e auditimit të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga subjektet zgjedhore, si dhe të kandidatëve për kryetar bashkie për fushatën zgjedhore për zgjedhjet e pjesshme vendore, të datës 6 mars 2022.

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kanë depozituar dokumentacionin 3 (tre) aplikantë të interesuar, që mbajnë titullin ekspertë kontabël të licensuar (auditues ligjor), për auditimin e fondeve të përfituara dhe të



shpenzuara nga subjektet zgjedhore, si dhe kandidatët për kryetar bashkie, për fushatën zgjedhore për zgjedhjet e pjesshme vendore, të datës 6 mars 2022.

Komisioni i Posaçëm i ngritur për verifikimin e plotësimit të kriterëve formale të aplikantëve për auditimin e të ardhurave dhe shpenzimeve të subjekteve zgjedhore, si dhe kandidatëve për kryetar bashkie, për fushatën zgjedhore të datës 6 mars 2022 shqyrtoi të gjitha aplikimet e depozituara dhe në bazë të vlerësimit të nevojave të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve përzgjedhi aplikantët, të cilët plotësonin kriteret e përcaktuara.

Më datë 18.03.2022, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve organizoi shortin online për përzgjedhjen e ekspertëve kontabël të licensuar (auditues ligjor) për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga subjektet zgjedhore, si dhe kandidatët për kryetar bashkie, për fushatën zgjedhore për zgjedhjet e pjesshme vendore të datës 6 mars 2022.

Organizimi i shortit u bë si më poshtë:

Emrat e subjekteve zgjedhore dhe ekspertëve kontabël të licensuar (audituesve ligjor) u shënuan në letra të veçanta dhe pasi u lexuan të gjithë, para kamerave dhe mikrofonit, respektivisht u vendosën 5 (pesë) emrat e subjekteve zgjedhore në një enë transparente dhe 3 (tre) emrat e ekspertëve kontabël të licensuar në një enë tjetër transparente.

Duke qenë se janë 5 (pesë) subjekte zgjedhore dhe 3 (tre) ekspertë kontabël të licensuar (auditues ligjor), të përzgjedhur, ndarja u bë 2 (dy) ekspertë kontabël të licensuar (auditues ligjor) do auditojnë nga 2 (dy) subjekte zgjedhore dhe 1 (një) ekspertë kontabël i licensuar (auditues ligjor) do auditojë 1 (një) subjekt zgjedhor.

Përzgjedhja u bë duke tërhequr nga njëra enë transparente emrin e ekspertit kontabël të licensuar (auditues ligjor) dhe nga ena tjetër transparente emrin e subjektit zgjedhor.

PËR KËTO ARSYE:

Referuar neneve 19, pikat 1, shkronja “ë”, e 2, nenit 92/6 dhe 92/7, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe vendimit nr. 15, datë 26.2.2022, “Për disa shtesa në udhëzimin nr. 14, datë 9.6.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për caktimin e kriterëve, procedurat për përzgjedhjen dhe emërimin e ekspertëve kontabël të licensuar (audituesve ligjor) dhe kushtet kontraktuale për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike gjatë vitit kalendarik dhe subjektet zgjedhore dhe kandidatët e tyre në fushatën zgjedhore”,

V E N D O S :

1. Të miratojë rezultatin e shortit dhe të emëroj ekspertët kontabël të licensuar (auditues ligjor), të cilët do të auditojnë subjektet zgjedhore për fondet e përfituara dhe të shpenzuara për fushatën zgjedhore të datës 6 mars 2022, si më poshtë:



1. Silvana Gjikhima

- a) Partia Socialiste e Shqipërisë
- b) Partia Demokratike

2. Meri Lika

- a) Partia Lëvizja e Re
- b) Partia Demokristiane e Shqipërisë

3. Fatmira Kastrati

- a) Partia Lëvizja Socialiste për Integrim

- 2. Ekspertët kontabël të licensuar (audituesit ligjor) do të paraqesin pranë KQZ-së raportet e auditimit për fondet e përfituara dhe të shpenzuara nga subjektet politike, si dhe kandidatët për kryetar bashkie për fushatën zgjedhore 2022, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e lidhjes së kontratës.
- 3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, brenda 3 (tre) ditëve nga data e shpalljes.
- 4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

